



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

20510
Nr. _____ Prot

Shkodër, më 11.8.2026

VENDIM
254
Nr. _____ datë 11 / 8 / 2026

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 ,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; ligjit nr.79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar; ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar ne republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr.9270 date 29.07.2004 ”Për sistemin e adresave” të ndryshuar; ligjit nr.8308 date 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, të ndryshuar; ligjit nr.18/2017 “Për te drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjit nr.75/2019 “Për rininë”; Udhezimi nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.248, datë 27. 07.2026,
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Rudin Beka me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
 - për firmosje si nëpunës autorizues.
 - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.

 - për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtorite.
3. Zv/Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.

4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 11.08.2026 dhe përfundojnë me datë 17.08.2026, ora 16.00.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, z.Rudin Beka dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

